



CEZ SHPËRNDARJE

Përditësim i Aplikimit të Tarifave për vitet 2012 – 2014

**Përditësim i parametrave variabël për OSSH dhe FPP
për vitet 2012 – 2014**

**CEZ Shpërndarje, sh.a.
Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Palati 12/1
Tirana
Albania**

Pasqyra e lëndës

1.	Përmbledhje	3
2.	Përditësimi i parametrave variabël për 2012 – 2014.....	4
2.1.	Parashikimi i Kërkesës dhe Fluksit të Energjisë	4
2.1.1.	Të dhënat Bazë dhe Metodologjia	4
2.1.2.	Parashikimi i Fluksit Total të Energjisë në Rrjetin e Shpërndarjes.....	5
2.1.3.	Parashikimi për Konsumin e Energjisë	6
2.1.4.	Parashikimi i humbjeve për 2012-2014	8
2.2.	Çmimet e Energjisë për Import	10
2.3.	Normat shkëmbimit valutor	11
2.4.	Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit	11
2.5.	Të Ardhura të Tjera	12
2.5.1.	Lidhjet e Reja	12
2.5.2.	Të Ardhurat nga Energjia Reaktive	13
2.6.	Tarifa e FPSH	13
2.7.	Tarifa e transmetimit	13
3.	Përditësimi i parametrave fikse	14
3.1.	Shpenzimet Operative (OPEX)	14
3.2.	Kurba e Uljes së Humbjeve	15
3.3.	Efektet e përjashtimit të Dëmit Ekonomik nga bilanci energjetik	16
4.	Llogaritja e Borxhit të Keq Te Lejuar	17
4.1.	Kompensimi nga miratimi i Studimit të Borxhit të Keq	17
5.	Zëra të Rinj	19
5.1.	Borxhi i Keq për konsumatorët e Tensionit të Lartë	19
5.2.	Humbje në transformim	20
5.3.	Komponenti fiks tarifor i konsumatorëve të tensionit të mesëm	20
5.4.	Kostoja e disbalancave	20
6.	Përditësimi i Llogaritjes për të Ardhurat e Kërkuara për vitet 2012-2014.....	22
7.	Tarifat individuale për grupe përkatëse të konsumatorëve	24
7.1.	Tarifa e grupit të parë (tarifa sociale)	24
7.2.	Tarifat individuale në lidhje me nivelet përkatëse të tensionit	25
8.	Parimi i reflektimit të kostove reale në tarifa	27

1. Përmbledhje

Bazuar në Deklaratën rregullatore, paragrafi 1.3., CEZ Shpërndarje sh.a. (“CEZ Shpërndarje”), me anë të këtij dokumenti paraqet parametrat e përditësuar duke u bazuar në të dhënat aktuale për vitin 2012 si dhe në faktet e reja dhe propozimet të cilat ndikojne në Aplikimin e Tarifës për Periudhën e 3-të Rregullatore (2012 – 2014). Parametrat e përditësuar të cilët duhen marrë në shqyrtim gjatë rishikimit të tarifave janë:

- Parametrat variabël të cilët mund të pësojnë ndryshime çdo vit, si p.sh, Kërkesa për Energji, Energjia hyrese në Rrjetin e Shpërndarjes, Çmimet e blerjes së energjisë në tregun e hapur për të mbuluar humbjet, normat e shkëmit valutor, Kapitalin e Punës dhe WACC (kosto mesatare e ponderuar e kapitalit), tarifa e FPSH si dhe përditësimin e të Ardhurave të Tjera (nga Lidhjet e Reja dhe energjia Reaktive)
- Përditësimi i parametrave të cilët janë fikse nga vetë natyra e tyre, por mund të ndryshojnë si rrjedhojë e vendimeve dhe/ose konkluzioneve të grupit të punës sipas parashikimeve të Deklaratës Rregullatore siç është, vendimi i ERE-s për miratimin e Studimit të Borxhit të Keq dhe rekomandimi i Panelit të Rishikimit për nivelin e OPEX, miratuar për llogaritjen e tarifës së Shërbimeve të Shpërndarjes dhe të Shitjes me Pakicë për periudhën 2012 - 2014.
- Komponentë të rinj të cilët duhen marrë në konsideratë sipas opinionit tonë dhe të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose jo tek tarifat për përdoruesit fundorë si p.sh, humbje gjatë transformimit, efekti i largimit të Klientëve të Tensionit të Lartë në Studimin e Borxhit të Keq dhe prezantimin e komponentit fikse për konsumatorët e Tensionit të Mesëm.

Gjatë përgatitjes së ri-llogaritjes së tarifave, ne i kemi referuar parimit të reflektimit të kostos në tarife, parim i cili do të përmbushë kërkesat e Direktivës së BE-së 2009/72/EC. Gjithashtu, ne kemi marrë në konsideratë konkluzionet e diskutimeve tona me institucionet ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore, Sekretariati i Energjisë, USAID dhe të tjerë, në lidhje me strukturën e tarifës, parim në tarifës me dy blloqe, etj. Ne jemi plotësisht të bindur se aplikimi i këtyre parimeve do të sjellë stabilitet në sektorin e energjisë, duke dhënë efekte pozitive tek konsumatorët fundorë, të cilëve do t’u ofrohet shërbim me cilësi më të lartë.

Ne mbetemi në pritje dhe kemi vullnetin e mirë për të pasur dialog dhe diskutime intensive të përbashkëta me ERE-n për sa i përket Aplikimit të Tarifave, tashmë të dorëzuar. Besojmë se është në interesin e përbashkët të arrihen konkluzione që do të jenë të përshtatshme për të gjitha palët e përfshira dhe që do të garantojnë zhvillim të mëtejshëm të rrjetit të shpërndarjes në Shqipëri, gjë që është e mundur vetëm nëpërmjet zbatimit të një model biznesi të qëndrueshëm dhe efektiv. .

2. Përditësimi i parametrave variabël për 2012 – 2014

2.1. Parashikimi i Kërkesës dhe Fluksit të Energjisë

2.1.1. Të dhënat Bazë dhe Metodologjia

Të dhënat historike të përdorura për parashikimin e fluksit total të energjisë në rrjetin e shpërndarjes dhe konsumin e energjisë për të gjithë konsumatorët e CEZ Shpërndarje janë bazuar në:

- a) Bilancin e Energjisë për periudhën Janar 2007- Qershor 2012;
- b) Strukturat e Shitjeve për periudhën Janar 2009 – Maj 2012.

Duke supozuar se sjellja e konsumatorëve do të jetë e ngjashme lidhur me konsumin historik të viteve të mëparshme, modeli i përdorur për parashikimin është bazuar në Ecurine dhe Sezonalitetin. Përveç kësaj, janë marrë në konsideratë edhe të tjerë elementë, si p.sh, plani i CEZ Shpërndarje për uljen e humbjeve për vitet 2012-2014. Në mënyrë që të dhënat historike të paraqesin një tendencë më të besueshme dhe të saktë për qëllimet e parashikimit, ato janë pastruar nga fluksi energjisë dhe konsumi i konsumatorëve në tensionin e lartë, të cilat, duke filluar nga Janari 2012, kane perfituar statusin e klientëve të kualifikuar dhe nuk furnizohen me energji elektrike nga CEZ Shpërndarje.

2.1.2. Parashikimi i Fluksit Total të Energjisë në Rrjetin e Shpërndarjes

Fluksi Total i Energjisë në Rrjetin e Shpërndarjes përfshin energjinë për të plotësuar nevojat e konsumatorëve të CEZ Shpërndarje dhe energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Për qëllime parashikimi, është ndarë në dy komponentë si më poshtë:

- a) Fluksi Energjisë nga OST, dhe
- b) Energjia e prodhuar nga HEC-et private dhe me koncesion të lidhura në rrjetin e shpërndarjes.

Këto dy komponentë të energjisë totale për CEZ Shpërndarje janë parashikuar në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, por duke ndjekur të njëjtën metodë dhe duke u bazuar në të dhënat historike.

Fluksi total i energjisë për gjithë vitin 2012 është llogaritur si shumë e fluksit aktual të energjisë për gjashtëmuajorin e parë dhe fluksi i parashikuar i energjisë për gjashtëmuajorin e dytë. Parashikimi për gjashtëmuajorin e dytë të 2012 është bazuar në hapat e mëposhtëm:

- 1) Norma mesatare mujore e ndryshimit të fluksit të energjisë është llogaritur çdo muaj bazuar në të dhënat historike mujore nga 2007 deri më 2012;
- 2) Parashikimi i fluksit për çdo muaj të gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2012 është llogaritur duke shumëzuar konsumin e muajit të mëparshëm me normën mesatare mujore të ndryshimit të fluksit të energjisë për muajin përkatës (ashtu siç është llogaritur në hapin 1);
- 3) Hapat 1 dhe 2 janë aplikuar në parashikimin e fluksit të energjisë nga OST dhe prodhimi i marrë nga HEC-et dhe shuma totale për çdo muaj është përdorur për të llogaritur parashikimin e fluksit total i energjisë në rrjetin e shpërndarjes për çdo muaj;
- 4) Fluksi total i energjisë për muajin ashtu siç është llogaritur në hapin 3 është rregulluar përsëri për të pasqyruar impaktin e planit të reduktimit të humbjeve (në lidhje me reduktimin e humbjeve teknike).

Parashikimi për fluksin total të energjisë për vitin 2013 dhe 2014 është bazuar në parashikimin total të vitit 2012, duke aplikuar normën e rritjes vjetore prej 2 % në vit. Kjo rritje është vlerësuar bazuar në faktorët e mëposhtëm:

- a) Norma e pritshme e rritjes së GDP për 2013 - 2014 nga disa burime;
- b) Norma mesatare e rritjes në fluksin e energjisë gjatë periudhës pesë vjeçare 2007 - 2012;
- c) Pritshmëritë tona në lidhje me sjelljen e konsumit për këtë periudhë

Parashikimi për fluksin total të energjisë për vitin 2013 dhe 2014 është korigjuar gjithashtu me atë pjesë të humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes të cilin ne e kemi gjykuar se është përtej niveleve normale në 2012 dhe të cilën ne besojmë se në të ardhmen do të shmanget nëpërmjet investimeve dhe menaxhimit më të mirë të ngarkesës dhe humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Veç kësaj, janë marrë në konsideratë edhe plane të tjera të CEZ Shpërndarje që kanë të bëjnë me reduktimin e humbjeve teknike.

Pas parashikimit të fluksit total të energjisë për vitet 2013 dhe 2014, alokimi mujor u bazua në mesataret e ponderuara të fluksit të energjisë të do muaji përkundrejt fluksit të energjisë gjatë vitit. Mesataret e ponderuara u llogaritën në bazë të së dhënave historike të periudhës 2007-2012, duke marrë kështu në konsideratë efektin sezonal të formës së konsumit të energjisë për çdo muaj.

2.1.3. Parashikimi për Konsumin e Energjisë

Parashikimi për Konsumin e Energjisë është bazuar në të dhënat historike të strukturave të shitjes së 2009 - 2012, por duke marrë parasysh vetëm konsumin e faturuar dhe konsumin e energjisë së llogaritur por të pafaturuar (UBE).

Parashikimi total vjetor për 2012 është nxjerrë nga konsumi aktual për pesë muajt e parë të vitit 2012 dhe konsumin e parashikuar për periudhën e mbetur shtatë-mujore. Në parashikimin për periudhën e mbetur shtatë-mujore të vitit 2012, u aplikua metoda “nga poshtë lart”, duke filluar me parashikimin e konsumit për çdo kategori të ndarë të strukturës së shitjeve, në mënyrë që arrihet në konsumin total

të çdo muaji përkatës, në përputhje me hapat e mëposhtëm (në të njëjtën mënyrë me hapat e ndjekur në parashikimin e fluksit të energjisë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2012).

- 1) Muaji mesatar mbi normën e ndryshimit të konsumit për muajin është llogaritur për çdo kategori të strukturës së shitjeve (e klasifikuar nga tensioni, sektori dhe orët pik – jo-pik), bazuar në të dhënat historike mujore nga 2009 – 2012;
- 2) Konsumi i parashikuar për çdo muaj për shtatë muajt e mbetur të vitit 2012 është llogaritur duke shumëzuar konsumin i muajit të mëparshëm me normën mesatare mujore të ndryshimit në konsumit për muajin përkatës. (siç është llogaritur në hapin 1);
- 3) Hapat 1 dhe 2 janë aplikuar në parashikimin e konsumit për çdo kategori të strukturës së shitjeve dhe shuma totale e tyre është përdorur për të llogaritur parashikimin e konsumit total për çdo muaj;
- 4) Konsumi mujor total, i llogaritur në hapin 3, është korrigjuar me qëllim që të reflektojë efektin e planit të reduktimit të humbjeve.

Parashikimi i konsumit të energjisë për viteve 2013 dhe 2014, në ngjashmëri me parashikimin e fluksit të energjisë, është bazuar në sasinë totale të parashikuar për vitin 2012, duke aplikuar normën e rritjes vjetore prej 2 % në vit. Veç kësaj, planet për reduktimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje nëpërmjet instalimit të elektromatësve të rinj, përmirësimin në faturim dhe penalizmin e vjedhjes së energjisë, janë reflektuar gjithashtu në parashikim.

Parashikimi i konsumit është bërë duke marrë parasysh vendimin e ERE-s për për përjashtimin e “Dëmit Ekonomik” nga energjia e faturuar. Ne e kemi përdorur atë parim vetëm për përshtatësinë e llogaritjes dhe për të shmangur çdo dyshim, kjo qasje nuk përfaqëson konsensusin e CEZ Shpërndarje. Ne e konsiderojmë këtë situatë si një çështje e hapur për negociata për një “kompromis më të gjerë” me autoritet shqiptare.

2.1.4. Parashikimi i humbjeve për 2012-2014

Fluksi total i energjisë në rrjetin e shpërndarjes dhe energjia e shitur ndaj konsumatorëve (konsumi) për çdo muaj të periudhës 2012 – 2014, na mundëson të parashikojmë humbjet si diferencë ndërmjet këtyre dy elementeve për çdo muaj. Për llogaritjen e humbjeve u mor si referencë pika 4.5 e deklaratës rregullatore, si vijon: “... Përqindja e humbjeve të energjisë në rrjet do të kuptohet si diferencë ndërmjet energjisë së marrë nga sistemi i shpërndarjes dhe energjisë së faturuar ndaj konsumatorëve fundorë, përqindje që reflektohet si energji e marrë nga sistemi i shpërndarjes...”

Do të donim të theksonim që llogaritja e thjeshtë e fluksit total të përftuar nga parashikimi i konsumit dhe niveli i humbjeve i njohur për qëllime të tarifave me anë të Vendimit të ERE-s no. 147 të datës 7 dhjetor 2011, çon në rezultate mjaft të pasakta. Në tabelën e mëposhtme tregohet. **ndryshimi** ndërmjet llogaritjes së saktë dhe asaj të kryer nga ERE

	2012			2013			2014		
	Aproved by ERE	New Forcast	Differences	Aproved by ERE	New Forcast	Differences	Aproved by ERE	New Forcast	Differences
Energy Demand	5 404	6 862	1 458	5 339	6 552	1 213	5 352	6 522	1 170
Energy Sales	4 111	4 199	88	4 279	4 571	296	4 446	4 850	404
Energy Losses	1 293	2 663	1 370	1 064	1 982	918	906	1 672	766

Fig. 1: Përmbledhje e fluksit total, energjisë së faturuar dhe humbjeve në rrjet për periudhën 2012 – 2014

Ne vijim, po ju paraqesim konsumin e energjisë elektrike të parashikuar për çdo grup të konsumatorëve të ndare sipas nivelit të tensionit (“struktura e shitjes”).

SALES STRUCTURE FORECAST 2012 - 2014					
IN MWH		ACT	FRC	FRC	FRC
		YTD 2011	YTD 2012	YTD 2013	YTD 2014
Industry	base	458 899	267	-	-
	peak	94 046	52	-	-
	total	552 944	319	-	-
Commerce and Services	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Agriculture	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Others	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Customers at 110 kV					
Industry	base	52 455	15 177	16 520	17 528
	peak	-	3 182	3 464	3 675
	total	52 455	18 359	19 984	21 204
Commerce and Services	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Agriculture	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Others	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Customers at 35 kV					
Industry	base	12 062	6 811	7 414	7 866
	peak	552	475	517	549
	total	12 613	7 287	7 931	8 415
Commerce and Services	base	21 955	41 096	44 732	47 463
	peak	4 342	8 550	9 307	9 875
	total	26 297	49 646	54 039	57 337
Agriculture	base	-	-	-	-
	peak	-	-	-	-
	total	-	-	-	-
Others	base	2 590	1 892	2 060	2 185
	peak	2 087	1 332	1 449	1 538
	total	4 677	3 224	3 509	3 723
Customers at 20/10/6 kV					
Industry	base	280 937	316 484	344 487	365 515
	peak	28 125	36 870	40 132	42 581
	total	309 062	353 354	384 619	408 096
Commerce and Services	base	158 006	221 394	240 983	255 692
	peak	18 105	17 986	19 577	20 772
	total	176 110	239 380	260 560	276 465
Wheat industry and bakeries	base	8 373	7 969	8 674	9 203
	peak	1 120	1 062	1 156	1 227
	total	9 493	9 031	9 830	10 430
Agriculture	base	1 077	4 678	5 092	5 402
	peak	77	273	297	316
	total	1 154	4 951	5 389	5 718
Others	base	190 203	104 466	113 709	120 650
	peak	22 528	26 748	29 115	30 892
	total	212 730	131 214	142 824	151 542
Budgetary	base	48 464	43 062	46 872	49 733
	peak	2 911	3 200	3 483	3 695
	total	51 375	46 261	50 355	53 428
Customers at 0,4 kV					
Commercial					
Industry	base	5 849	14 405	15 679	16 636
	peak	-	-	-	-
	total	5 849	14 405	15 679	16 636
Commerce and Services	base	618 916	709 538	772 319	819 461
	peak	-	27	30	31
	total	618 916	709 565	772 349	819 492
Wheat industry and bakeries	base	39 326	36 353	39 569	41 985
	peak	-	-	-	-
	total	39 326	36 353	39 569	41 985
Agriculture	base	2 869	1 469	1 599	1 696
	peak	-	-	-	-
	total	2 869	1 469	1 599	1 696
Others	base	75 878	42 804	46 591	49 435
	peak	-	3	3	3
	total	75 878	42 807	46 594	49 438
Budgetary	base	126 703	115 432	125 645	133 315
	peak	11	68	74	78
	total	126 692	115 500	125 719	133 393
Residential					
<300 kWh	base	1 507 056	1 548 775	1 685 813	1 788 714
	>300 kWh	755 533	804 872	876 089	929 564
Common spaces Private & Household	base	48 895	59 450	64 711	68 661
	total	2 311 484	2 413 097	2 626 612	2 786 939
Own consumption					
Own consumption MV & LV	base	4 652	635	691	733
	peak	6	9	10	10
Own consumption HV	base	3 924	2 470	2 689	2 853
	total	8 582	3 114	3 390	3 597
Grand total		4 598 507	4 199 334	4 570 551	4 849 534

Fig 2: Struktura e shitjes 2012 – 2014

2.2. Çmimet e Energjisë për Import

Më poshtë mund të gjeni përditësimin e çmimeve të energjisë elektrike për periudhën janar-gusht 2012 si edhe parashikimin për pjesën e mbetur të vitit 2012 dhe vitet 2013 dhe 2014. Volumet e parashikuara për vitin 2012 bazohen në ofertat e marra aktualisht nga tregtarët gjatë tenderave të organizuar nga CEZ Shpërndarje dhe/ose volumet tashmë të kontraktuara në bazë të tenderit vjetor.

ENERGY BALANCE 2012 IN MWH								
Year	Month	Average price of the contracted Import (Eur/MWh)	Average price of the offers with CEZ Shp CBC (Eur/MWh)	Average price of the offers with Suppliers CBC (Eur/MWh)	Procured energy for covering losses - yearly tender FACT	Procured energy for covering losses - monthly	Procured energy for covering losses - TOTAL	Cost of energy for imports (in EUR)
2012	Jan	62,40			111 600	0,00	111 600,00	6 963 840
2012	Feb	69,75			104 400	174 000,00	278 400,00	19 418 400
2012	Mar	64,60			222 900	147 137,00	370 037,00	23 902 626
2012	Apr	57,66			108 000	129 600,00	237 600,00	13 700 448
2012	May	59,32			111 600	54 720,00	166 320,00	9 866 830
2012	Jun	59,72			108 000	43 200,00	151 200,00	9 029 664
2012	Jul	62,52			77 712	1 800,00	79 512,00	4 971 090
2012	Aug	65,71			37 019	148 800,00	185 819,00	12 210 766
2012	Sep	62,40	62,52	68,35	108 000	144 000,00	252 000,00	16 581 600
2012	Oct	62,40	65,04	70,54	111 750	148 800,00	260 550,00	17 469 552
2012	Nov	62,40	66,29	71,62	108 000	144 000,00	252 000,00	17 052 480
2012	Dec	62,40	66,60	72,11	111 600	148 800,00	260 400,00	17 693 808
2012	TOTAL				1 320 581	1 284 857	2 605 438	168 861 104

	CBC price	Final Price
Average price for 2012 *	64,81	64,81
Average price for 2013	58,40	64,40
Average price for 2014	58,25	64,25

Note Prices and quantities for Sept-Dec 2012 are as per the bid obtained in the tender issued by CEZ Shpërndarje in August, 2012 prices already includes CBC's*

Fig 3:Përmbledhje e çmimeve të energjisë për import për vitin 2012

Çmimet e parashikuara për vitin 2013 dhe 2014 bazohen në bursën Hungareze të energjisë elektrike. Për qëllime të llogaritjes së tarifave, supozojmë se kostoja totale e transmetimit nga Hungaria në Shqipëri është mesatarisht 6 Euro për MW. Në çdo rast, CEZ Shpërndarje ka organizuar tenderin për energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në vitin 2013 me oferta të cilat do të paraqiten nga tregtarët gjatë muajit shtator. Ne do t'i dërgojmë ERE's çmimin e përditësuar të energjisë elektrike

bazuar në rezultatet e tenderit dhe situatën CBC gjatë vjeshtës me përditësimin vijues të llogaritjes së tarifave.

2.3. Normat shkembimit valutor

Kemi përditësuar normën e parashikuar të shkembimit valutor për vitin 2012 bazuar mbi normën aktuale në janar deri në korrik për blerjen e energjisë për të mbuluar humbjet. Norma e shkembimit valutor është përcaktuar në 139,58 LEK/EUR. Për llogaritjen e vitit 2013 dhe 2014 kemi mbajtur normën e shkembimit të përdorur fillimisht prej 140,75 LEK/EUR duke qenë se nuk ka ndonjë ndryshim domethënës në parashikimet e tregut për të cilin të jemi në dijeni.

2.4. Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit

Ne kemi përditësuar nivelin e EURIBOR –it 6-mujor duke ndjekur të njëjtën logjikë si një vit më parë, pra, duke marrë parasysh mesataren e EURIBOR-it 6-mujor në fillim të çdo muaji të vitit 2012, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme (burimi: www.euribor-rates.eu).

6M EURIBOR	MES
Norma në ditën e parë të muajit	1,110%
8.1.2012	0,664%
7.2.2012	0,928%
6.1.2012	0,943%
5.2.2012	0,992%
4.2.2012	1,072%
3.1.2012	1,267%
2.1.2012	1,409%
1.2.2012	1,61%

Fig 4:Përmbledhje e 6M EURIBOR janar - gusht 2012

Duke qenë se EURIBOR 6-mujor tregon një rënie të lehtë, ne e kemi rillogaritur Koston Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC) bazuar mbi këtë ndryshim të EURIBOR-it 6-mujor nga 1,56% të përdorur një vit më parë në 1,11% bazuar në zhvillimet më të fundit. Impakti ndaj WACC paraqitet në tabelën më poshtë:

	2012	2013	2014
WACC siç zbatohet në aplikim	9.72%	10.18%	10.00%
WACC e përditësuar	9.60%	10.01%	9.88%

Fig 5: Krahasimi i WACC në Aplikimin fillestar dhe të përditësuar të Tarifave 2012 - 2014

2.5. Të Ardhura të Tjera

2.5.1. Lidhjet e Reja

Ne kemi rishikuar ecurinë e lidhjeve të reja dhe të ardhurave të tjera në vitin 2011 dhe në gjysmën e parë të vitit 2012, siç tregohet në tabelën më poshtë, dhe kemi përdorur rezultatet për saktësimin e volumeve të parashikuara për vitet 2012-2014. Të dhënat tregojnë një ecuri në rënie në numrin e lidhjeve të reja kryesisht në rrjetin e tensionit të ulët.

Nr i lidhjeve të reja	2011	H1 2012
Tension Mesatar	628	249
Tension i Ulët	13'800	5'460
Të Ardhurat nga Lidhjet e Reja (ths ALL)	486'897	208'835

Fig 6: Të ardhurat nga lidhjet e reja

Bazuar në ecurinë e përmendur më lart, të ardhurat nga lidhjet e reja dhe të ardhurat shpeshë (për shembull ndryshim kontrate, zhvendosje të matësive, transferim i pikës lidhëse, rilidhje etj) përllogariten në nivelin e 420 milion Lek për vitin 2012 dhe 450 milion Lek për çdo vit pasues.

Të ardhurat e pritshme janë zbritur nga të Ardhurat e Kërkuara të OSSH para ndarjes në tarifat përkatëse të Shpërndarjes.

2.5.2. Të Ardhurat nga Energjia Reaktive

CEZ Shpërndarje ka përdorur për vlerësimin e të ardhurave të pritshme nga energjia reaktive në aplikimin e tarifave 2012-2014, të ardhurat e kërkuara të llogaritura për energjinë reaktive të vitit 2012 e barabartë me 300 mil Lek.

Aktualisht, për gjysmën e parë të vitit 2012, të ardhurat nga energjia reaktive janë në nivelin e vetëm 4 milion Lek. Arsyeja për të ardhura kaq të ulëta nga energjia reaktive është impakti material i Kredit-Notave të lëshuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 në shumën neto prej 169 milion Lek. Parashikimi i të ardhurave nga energjia reaktive për gjashtë muajt pasardhës të vitit 2012 do të jetë 170 milion Lek. Rrjedhimisht, të ardhurat totale nga energjia reaktive për vitin 2012 do të jenë 174 milion Leke, në vitin 2013 dhe 2014 ne parashikojmë 350 milion Leke.

2.6. Tarifa e FPSH

Sipas vendimit të ERE-s, Nr. 87, datë 29.06.2012, "Rishikimi i tarifave për Furnizuesin Publik me Shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 për akomodimin e efekteve financiare të vendimit Nr. 80, datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në të cilin u miratua rishikimi i tarifës së FPSH për periudhën 2012-2014 nga 2.83 Lek/kWh në 2.2 Lek/kWh, në llogaritjen e përditësuar ne kemi përdorur 2.2 Lek/kWh si çmim blerjeje nga FPSH për të gjithë periudhën 2012-2014.

2.7. Tarifa e transmetimit

Tarifa e transmetimit e përdorur me qëllim llogaritjen e tarifave të OSSH dhe FPP është 0.65 ALL/kWh, sipas vendimit të ERE's Nr. 146, datë 07 dhjetor 2011.

3. Përditësimi i parametrave fikse

3.1. Shpenzimet Operative (OPEX)

Një nga elementët kyç për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve që i ofrohen klientit fundor janë edhe projektet e transformimit të planifikuara nga CEZ Shpërndarje, të cilat duhet të mbulohen nga Shpenzimet Operative të njohura në tarifrat përkatëse. Prandaj do të donim të kthenim vëmendjen e ERE's tek niveli i OPEX-it dhe, në përputhje me rekomandimin e Procedurës së Panelit Rishikues datë 18 janar 2012 sipas të cilit “...niveli i shkurtimeve të OPEX-it që propozon ERE është tepër drastik. Për këtë arsye, Paneli Rishikues rekomandon që ERE t'i rishikojë parashikimet e saj të OPEX-it...”, të rishikohet edhe një herë nivelin e OPEX-it të njohur për qëllime tarifore. CEZ Shpërndarje shpreh gatishmërinë për t'i paraqitur ERE-s detaje të tjera nëse kërkohen dhe bihet dakord për strukturën dhe formën e këtyre detajeve.

Ne e kemi rishikuar nivelin e parashikuar të OPEX-it bazuar në shpenzimet aktuale në gjysmën e parë të vitit 2012 si edhe duke marrë parasysh që projektet e transformimit të cilat kishin mbetur pezull për shkak se kostot e tyre nuk njiheshin nga ERE, do të rifillojnë gjatë 2013-2014. Vlerësimi aktual i nivelit të OPEX-it në vitet 2012-2014 jepet në tabelën më poshtë. Për llogaritjen e tarifave të OSSH-së dhe FPP-së, merret parasysh mesatarja gjatë një periudhe 3 vjeçare. Për më tepër, në vijim të vendimit të ERE-s për të mos i alokuar më CEZ Shpërndarjes Kapacitetet Ndërkufitare të Transmetimit në vitin 2012 por për t'i nxjerrë ato në ankand, do të donim të theksonim se Pakti Evropian i Energjisë përcakton se rregullatorët e vendit duhet ose të kompensojnë pjesëmarrësit e tregut për kostot e CBC-ve ose të korigojnë tarifën e OST-së për të reflektuar të ardhurat shtesë nga ankandet. Duke qenë se kjo e fundit nuk u zbatua në Shqipëri, ne kërkojmë kompensimin e kësaj kostoje në OPEX-in e njohur për qëllim të tarifave të OST-së sipas llogaritjes së mëposhtme.

No	CEZ SHPËRNDARJE OPEX ths (ALL)	Total			Sales			Distribution		
		FY 2012	FY 2013	FY 2014	FY 2012	FY 2013	FY 2014	FY 2012	FY 2013	FY 2014
1	Personnel costs	3 161 917	3 572 364	4 036 771	476 963	539 260	609 364	2 684 954	3 033 104	3 427 407
2	Postage & telecommunications	798 959	822 928	847 616	675 690	696 048	716 929	123 270	126 881	130 687
3	Materials	833 728	858 740	884 502	99 183	102 183	105 248	734 545	756 557	779 254
4	Repair and maintenance	62 717	64 145	66 069	10 195	10 062	10 364	52 522	54 083	55 705
5	Transfers, travels & per diem	61 304	63 143	65 038	5 334	5 503	5 668	55 970	57 640	59 369
6	Consulting and audit	394 586	406 423	418 616	278 538	286 977	295 587	116 047	119 446	123 029
7	Corporate services	1 246 255	1 172 572	1 206 549	147 981	137 344	141 295	1 098 274	1 035 227	1 065 254
8	Security costs	186 818	192 423	198 195	39 797	41 096	42 329	147 021	151 327	155 867
9	Penalties, fines & demneties	128 695	132 556	136 533	24 557	25 335	26 095	104 138	107 222	110 438
10	Rents	343 972	354 291	364 920	103 584	106 802	110 006	240 387	247 489	254 914
11	Other costs	1 232 042	2 454 311	2 527 941	719 270	1 234 368	1 271 399	512 773	1 219 943	1 256 541
Total OPEX		8 450 995	10 093 896	10 752 750	2 581 093	3 184 978	3 334 284	5 869 902	6 908 918	7 418 466
3Y AVERAGE		9 765 880			3 033 451			6 732 429		

CBC's cost on Losses

Total Losses GWh	2 663	1 982	1 672
Already covered GWh	1 984	1 772	1 569
Delta to be compensated	679	209	103
AVG CBC price in EUR	3,00	3,00	3,00
CBC's costs mil EUR	2 038	628	309
FX rate	139,58	140,75	140,75
CBC's costs mil LEK	284 474	88 436	43 451
Final DSO OPEX	6 154 376	6 997 354	7 461 917
Final AVG DSO OPEX	6 871 216		

Fig 7: Përmbledhje e OPEX-it 2012 - 2014

3.2. Kurba e Uljes së Humbjeve

CEZ Shpërndarje, në përputhje me Deklaratën Rregullatore, pika 4.5, e cila përcakton se “.... Në bazë të Studimit të Humbjeve, OSSH do t'i propozojë ERE's një program për uljen e humbjeve totale për tre periudhat rregullatore të përmendura më lart të ndara në vite, të lidhur me planin e investimeve për uljen e humbjeve sipas këtij programi, nëse skenari i propozuar nga ERE nuk konsiderohet i përshtatshëm”, insiston në pozicionin e tij që plani për uljen e humbjeve duhet të rishqyrtohet nga ERE. Në Modelin e Uljes së Humbjeve, i cili është në përputhje me konkluzionet e Studimit të Humbjeve realizuar nga PWC, i cili ishte gjithashtu i miratuar nga ERE, është përcaktuar se programi i uljes do të jetë 2% në vitin 2012, 2% në vitin 2013 dhe 3% në vitin 2014 në varësi të programeve të planifikuara të investimit. Ky program për uljen e humbjeve është bazuar në supozimin se programi i investimit do të zbatohet siç është paraqitur PWC-së nga CEZ Shpërndarje. Mungesa e huasë së investimeve gjatë vitit 2010-2011 – 1Q2012 pati një impakt të konsiderueshëm në betejën frytdhënëse

kunder vjedhjeve si edhe në nivelin e humbjeve teknike në rrjet. Pamundësia për të investuar është shkaktuar nga mospërmbushja e “Kushteve Paraprake” të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë me BERZH dhe IFC. Mospërmbushja e pjesës kryesore të “Kushteve Paraprake” është shkaktuar nga mungesa e miratimeve dhe/ose veprimeve apo mos veprimeve nga ERE, konkretisht mosmiratimi i Studimit mbi Borxhin e Keq, mosmiratimi i marreveshjes së vendosjes si garanci të asetëve dhe mosrregullimi i kurbës së uljes së humbjeve bazuar në Modelin e Uljes së Humbjeve nga PWC. Pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj sjelljeje të ERE-s ka qenë mungesa e fondeve të mjaftueshme për investime me qëllim përmirësimin e rrjetit, izolimin e linjave dhe rindërtimin e pikave të lidhjes të cilat janë kushte thelbësore për të mundësuar uljen e humbjeve, jo vetëm ato teknike por edhe ato jo-teknike. Do të donim të theksonim se është e pamundur të ulësh me sukses humbjet jo-teknike pa parandaluar rilidhjet e paligjshme të hajdutëve në rrjet. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet investimeve masive në rrjet, fondi për të cilat u bllokua dhe ende varet nga vendimet e ERE’s. Për këtë arsye, na duhet të insistojmë në zbatimin e Nenit të sipërpërmendur 4.5 të Deklaratës Rregullatore dhe t’i kërkojmë ERE-s që të rishqyrtojë programin për uljen e humbjeve në përputhje me Modelin për Uljen e Humbjeve të paraqitur nga PWC, i cili perben tashme një sfidë dhe paraqitet shumë i vështirë për t’u realizuar për shkak të mungesës së investimeve siç u shpjegua më lart.

3.3. Efekti i përjashtimit të Dëmit Ekonomik nga bilanci energjetik

Dëmi Ekonomik ishte një mjet tejet i rëndësishëm për uljen e humbjeve jo-teknike sipas Modelit të Uljes së Humbjeve. Ne do të donim të theksonim se vendimi i ERE’s për të përjashtuar Dëmin Ekonomik nga bilanci energjetik po rrit nivelin e humbjeve. Sipas Modelit të Uljes së Humbjeve, efekti i DE duhet të jetë 205 GWh për çdo vit. Për këtë arsye, CEZ Shpërndarje, në këtë përditësim të Aplikimit të Tarifave, po mbështetet në ri rregullimin e të ardhurave të kërkuara duke rritur nivelin e humbjeve të njohura me këtë shumë për vitin 2012, 2013 dhe 2014, e llogaritur me ndryshimin ndërmjet çmimit të importit dhe çmimit të FPSH.

Për të shmangur dyshimet, kjo nuk përbën konsensusin e CEZ Shpërndarje për trajtimin e “Dëmit Ekonomik” dhe ne e konsiderojmë këtë një pikë të hapur në negociimin për “kompromis më të gjerë” me autoritet shqiptare.

4. Llogaritja e Borxhit të Keq Te Lejuar

4.1. Kompensimi nga miratimi i Studimit të Borxhit të Keq

Për nivelin e llogaritjes së Borxhit të Keq te Lejuar kemi marrë parasysh vlerat e përditësuara që rezultojnë nga vendimi i ERE-s Nr. 80, datë 15.06.2012, “Për Miratimin e Studimit të Borxhit të Keq”.

	Niveli i mëparshëm i BDS	Niveli i Përditësuar i BDS
2009	14%	16.85%
2010	13%	15.85%
2011	12%	14.85%
2012	11%	13.85%
2013	10%	12.85%
2014	9%	11.85%

Fig 8:Krahasimi i niveleve të Borxhit të Keq 2012 - 2014

Llogaritja e shumës së kompensimit për vitet 2009 dhe 2010 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Calculation of Bad Debt Allowance compensation for 2009 - 2010

in mil. LEK	2009	2010	
DSO Approved Revenue	20 675	24 112	
RPS			
Purchased EE	6 707	8 868	
Cost of OST	2 094	2 640	
OPEX	652	774	
Margin from purchased EE	148	195	
Bed Debts ratio	16,85%	16,85%	
Bed Debts Allowance	6 135	7 415	
ERE decision	4 238	4 756	
Addition to Compensation	1 897	2 658	
WACC 2009	7,90%	2 047	
WACC 2010	10,48%	2 261	2 937
WACC 2011	9,98%	2 487	3 230
WACC 2012	9,60%	2 725	3 540
Total addition to compensation	6 265		

Fig 9: Llogaritja e Kompensimit të Lejimit të Borxhit të Keq 2009 - 2010

Kompensimi i të ardhurave të vitit 2011 bëhet drejtpërdrejt në rilogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara për vitin 2011 të paraqitura në Kapitullin 6 të këtij Përditësimi të Aplikimit të Tarifave, ndaj dhe nuk është llogaritur në kete paragraf.

5. Zëra të Rinj

5.1. Borxhi i Keq për konsumatorët e Tensionit të Lartë

Bazuar në ndryshimin e Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike të miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë më 26 nëntor 2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 164, më 19 dhjetor 2011, dhe i cili hyri në fuqi më 3 janar 2012, CEZ Shpërndarje ka humbur një pjesë të mirë të klientëve të tij. Duke qenë se këto klientë kanë treguar një korrektësi të përsosur në pagesë, përjashtimi i tyre nga portofoli i klientëve tariforë ka një impakt të konsiderueshëm në nivelin e Borxheve të Këqija. Në këtë përditësim ne e llogaritëm efektin e largimit të klientëve të tensionit të lartë në nivelin e Borxhit të Keq. Rillogaritja u krye duke u bazuar në pagesën historike të këtyre konsumatorëve. Ata të gjithë rezultuan se ishin pagues 100% të rregullt të energjisë, pa debi në principal. Më poshtë mund të gjeni efektin e tyre në nivelin e Borxhit të Keq.

Calculation of Bad Debt % adjustment due to forced change in customers portfolio

	in ths. LEK	Actuals 2011
Sales to HV customers		3 877 050
Sales to Other customers		40 542 816
Total Revenues		44 419 866
Bad Debt Allowance on Total portfolio	15,85%	7 040 549
Bad Debt Allowance on portfolio w/o HV customers	17,37%	7 040 549
Delta in Bad Debt %		1,52%

Fig 10: Llogaritja e impaktit të konsumatorëve të TL në lidhje me nivelin e Borxhit të Keq

5.2. Humbje në transformim

Do të donim të kthenim vëmendjen tuaj edhe një herë në propozimin tonë të mëparshëm për futjen e parimit sipas të cilit kostoja e humbjeve në transformim të mbulohet nga konsumatorët të cilët maten në anën sekondare të transformatorit që ata kanë nën pronësi, por duke i tarifuar ata me çmime të konsumatorëve të lidhur në tension të mesëm (kabinë me një klient të vetëm, i lidhur në kabinën që zotërohet prej tij). Jeni të lutur t'i referoheni kapitullit dhe shtojcës përkatëse të Aplikimit të Tarifave 2012-2014.

5.3. Komponenti fiks tarifor i konsumatorëve të tensionit të mesëm

Prezantimi i komponentit fiks të trifasë së konsumatorëve të lidhur në TM është një tjetër propozim nga Aplikimi i Tarifave 2012-2014, të cilin CEZ Shpërndarje ia rekomandon ERE's për rishqyrtim dhe vlerësim. Ne e konsiderojmë komponentin fiks tarifor për klientët TM dhe TL si fillimin e një procesi disaveçar i cili do të rezultojë në një status i cili ndihmon operatorin që ta operojë rrjetin me efektivitet, që ta mirëmbajë rrjetin dhe gjithashtu të identifikojë rezervat e kapaciteteve në rrjet, duke përfshirë investime efektive. Pagesa për fuqinë e instaluar do të bëjë që gjithashtu të motivohen edhe klientët që të negociojnë/përditësojnë fuqinë optimale që u nevojitet për bizneset dhe që ta përdorin këtë fuqi me efektivitet. Në këtë mënyrë, OSSH do të mund t'i përdorë linjat aktuale me më shumë efektivitet, për më shumë klientë, me siguri më të lartë. Bazuar në njohuritë tona, një komponent i tillë përdoret gjerësisht në shumë modele eficientë të tregut në mbarë Evropën.

CEZ Shpërndarje rekomandon në mënyrë të perseritur futjen e komponentit fiks tarifor në strukturën tarifore.

5.4. Kostoja e disbalancave

Gjatë vitit 2012 ERE vendosi të bënte disa rishikime në Rregullat e Tregut duke miratuar kushtet e reja të rregullave të planifikimit dhe balancimit. Rregullat e reja të balancimit e ekspozuan CEZ Shpërndarjen në rolin e shpërndarësit dhe furnizuesit tarifor si përgjegjes për disbalancat, duke e

ngarkuar me përgjegjësi financiare për devijimet e shkaktuara, gjë që solli shpenzime shtese për balancimin e portofolittë klienteve tarifore.

Në Prill, OST emetoi për CEZ Shpërndarje një faturë në vlerën e 146 mijë Euro për energjinë balancuese si pasojë e tejkalimit të kufirit prej 5% të përcaktuar nga ERE në vendimin Nr. 23, datë 24.02.2012. Në korrik, ERE vendosi përsëri ta ndryshonte Modelin e Tregut me vendimin Nr. 93, datë 16.07.2012, i cili hyri në fuqi më 1 gusht 2012.

Bazuar në kostot aktuale të balancimit për periudhën Prill-Gusht 2012, ne parashikojmë që kostot totale të balancimit për vitin 2012 të arrijne shumën prej 404 mijë EURO. Duke ndjekur supozimin kryesor të mos ndryshimit të logjikës dhe parametrave të llogaritjes së kostove të balancimit të deklaruar në Rregullat e Tregut, kostot e parashikuara për vitet e ardhshme 2013 dhe 2014 janë 756 mijë Euro.

Pas zbatimit të konceptit të përgjegjësisë së kostove të balancimit në tregun shqiptar të energjisë elektrike, kostot e balancës janë tashmë një pjesë e pandashme e strukturës tarifore të reflektuara në kosto të FPP dhe OSSH-së. Ne kërkojmë me këmbëngulje njohjen e plotë të kostove të përlllogaritura në strukturën tarifore. Paralelisht me këtë, ne kërkojmë vendosjen e rregullave strikte për grupin e përcaktuar të konsumatorëve më të mëdhenj industrialë me qëllim që t'i detyrojmë ata që t'i paraqesin CEZ Shpërndarjes plane javore dhe ditore lidhur me konsumin e parashikuar të tyre. Kjo qasje do të sjellë, në një perspektivë afatmesme, disiplinë dhe qëndrueshmëri më të lartë si edhe kosto më të ulëta të balancimit për sektorin e energjisë në përgjithësi.

Month	ALL '000
April	20 432
August	4 402
September	4 470
October	4 322
November	4 326
December	4 373
Total 2012	42 326
Total 2013	53 206
Total 2014	53 206

Fig 11: Cost of imbalances 2012 - 2014

6. Përditësimi i Llogaritjes për të Ardhurat e Kërkuara për vitet 2012-2014

Llogaritja e të Ardhurave të Kërkuara për çdo vit përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme. Jane përdorur parimet dhe metodat si me mëposhtë:

- A) **Rillogaritja e 2011** – të Ardhurat e Kërkuara për vitin 2011 janë rillogaritur bazuar në faktet e fundit të njohura. Me qëllim bashkërendimin e llogaritjeve të bëra nga CEZ Shpërndarje dhe nga ERE, ne kemi përdorur vlerat e balancimit të energjisë ashtu siç janë prezantuar nga ERE. Do të donim të theksonim se një fakt i tillë nuk përbën pëlqimin/konsensusin e CEZ Shpërndarje as për parimin e heqjes së Dëmit Ekonomik nga konsumi i faturuar i energjisë dhe as me korrigjimin e llogaritjes së “energjisë së pafaturuar” (UBE) në fund të vitit 2011. Ne i konsiderojmë këto çështje ende të hapur duke qenë se ata kanë qenë objekt negociimi si pjesë e “kompromisit më të gjerë”, i cili nuk është arritur ende plotësisht.

Një nga faktorët kryesorë për rillogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara për vitin 2011 është llogaritja e Borxhit të Keq të Lejuar në përputhje me Vendimin e ERE’s Nr. 80, datë 15 qershor 2012.

- B) **Kompensimi i Borxhit të Keq të Lejuar për 2009 – 2012** – rillogaritja e **Borxhit të Keq të Lejuar** dhe e vlerës që rrjedh prej tij për qëllim të llogaritjes së mekanizmit të kompensimit sipas Nenit 6 të Deklaratës Rregullatore është kryer dhe përshkruhet në Kapitullin 4.
- C) **Llogaritja e mekanizmit të kompensimit** – kompensimi për vitet përkatëse është llogaritur si **ndryshim** në të Ardhurat e Kërkuara të miratuara dhe në të Ardhurat e Kërkuara aktuale bazuar në llogaritjen e përditësuar. Kosto Mesatare e Ponderuar e Kapitalit (WACC) përkatëse është aplikuar.
- D) **Llogaritja e Tarifave Mesatare të Ponderuara për 2011 dhe 2012** – tarifatat për vitet 2013 dhe 2014 janë llogaritur duke synuar ndarjen e barabartë të të Ardhurave të Kërkuara në këto dy vite, gjë që do të shmangë rritjen e tarifës së vitit 2013, duke parashikuar një ulje më 2014.

Energy balance	2011		2012		2013		2014	
	Decision	Actual	Decision	Forecast				
Total billed energy	4 235	4 599	4 111	4 199	4 571		4 850	
<i>of which HV</i>	240	553						
<i>YoY increase</i>		8,58%	-10,60%	-8,68%	8,84%		6,10%	
Total Losses in Grid		2 439	1 293	2 663	1 982		1 672	
%		37,61%	23,92%	38,81%	30,25%		25,64%	
Losses Recognized for DSO tariff	1 547	1 811	1 293	1 984	1 772		1 569	
ED removal effect				205	205		205	
Losses as per %				1 779	1 567		1 364	
<i>Losses %</i>	27,92%	27,92%	23,92%	25,92%	23,92%		20,92%	
<i>Loss Reduction curve</i>				2,00%	2,00%		3,00%	
Total energy to distribution	5 542	6 485	5 404	6 862	6 552		6 522	
WPS tariff	1 480	1 480	2 844	2 200	2 200		2 200	
TSO tariff	600	600	613	645	645		645	
DSO								
Revenue from RAB	2 078	1 975	2 006	2 293	2 386		2 328	
<i>RAB value</i>	19 292	18 080	19 170	21 717	21 717		21 717	
<i>WACC</i>	9,98%	9,98%	9,72%	9,60%	10,06%		9,88%	
Depreciation	3 126	2 978	3 967	3 966	3 966		3 966	
Working Capital	1 530	1 715	1 462	2 175	2 007		1 840	
OPEX	6 697	6 697	5 398	6 871	6 871		6 871	
Compensation from 2010 (Cost of losses, ...)	2 421	2 421						
Cost of Losses	11 668	13 880	12 144	19 225	17 208		15 204	
<i>Import price</i>	50,29	50,29	62,40	64,81	64,40		64,25	
<i>Exchange rate</i>	138,00	140,50	140,75	139,58	140,75		140,75	
<i>Transmission cost</i>	928	1 086	792	1 280	1 143		1 012	
Total Revenue DSO	25 990	27 952	23 515	32 355	30 431		28 369	
<i>Other revenues (new connection, reactive)</i>	-580	-580	-500	-420	-450		-450	
<i>Other revenues (new connection, reactive)</i>	-235	-380	-300	-175	-350		-350	
Total Required Revenue DSO	25 175	26 992	22 715	31 760	29 631		27 569	
RPS								
Purchased energy costs	8 809	9 565	14 212	11 989	13 056		13 850	
<i>WPS</i>	6 268	6 806	11 693	9 239	10 055		10 669	
<i>Cost of Imbalances</i>				42	53		53	
<i>Transmission cost</i>	2 541	2 759	2 519	2 709	2 948		3 128	
Margin on supplied energy	138	150	257	203	221		235	
OPEX	1 875	1 875	1 573	3 033	3 033		3 033	
Bad debt allowance	4 349	7 339	3 884	9 226	8 402		7 553	
<i>Bad debt level (Bad debt study)</i>	12,00%	15,85%	11,00%	16,36%	15,36%		14,36%	
Total Required Revenue RPS	15 171	18 928	19 926	24 453	24 713		24 672	
Total Required Revenues	40 347	45 920	42 641	56 213	54 344		52 241	
Compensation			-3 449		23 212		15 300	
Total Required Revenues including Comp			39 192	56 213	77 557		67 540	
AVG EndUser Tariff Calculated	9 527	9 986	9 533	13 386	16 969		13 927	
Applied Weighted AVG tariff	9 527	9 679	9 530	10 204	13 927		13 927	
<i>AVG tariff increase</i>	0%	1,6%	0%	5,4%	36,5%		0%	
Total Revenue with applied tariff	40 347	44 507	39 178	42 852	63 655		67 540	
Compensation mechanism calculated	-0	1 413		13 361	13 902		0	
Compensation for Bad Debts 2009-10		6 265						
Compensation mechanism cumulated		7 819		21 180	13 902		0	

Fig 12: Llogaritja e përditësuar e të Ardhurave Totale të Kërkuara për OSSH dhe FPP për vitet 2011 - 2014

7. Tarifat individuale për grupe përkatëse të konsumatorëve

Për llogaritjen e tarifave individuale janë përdorur parimet e mëposhtme:

- 1) heqja e tarifës së bllokut të parë dhe ulje e lehtë e tarifës së bllokut të dytë për arsye të listuara më poshtë.
- 2) shpërndarje e thjeshtë e rritjes së të Ardhurave Totale të Kërkuara të aplikuar në mënyrë të barabartë për çdo grup të konsumatorëve.

Llogaritja është bërë duke synuar rregullime të lehta të tarifave dhe duke shmangur “kerçimin” më 2013 me ulje që pason në 2014. Ndryshimet në tarifat individuale të konsumatorëve fundorë paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Për tarifën e orëve të pikut, ne pretendojmë parim të pandryshuar d.m.th. 15% mbi tarifën bazë në çdo grup tarifor përkatës.

7.1. Tarifa e grupit të parë (tarifa sociale)

Do të dëshironim të përsërisim se jemi të bindur plotësisht se sistemi i tarifave me dy blloqe (e ashtuquajtura tarifë sociale) duhet të hiqet për shkak se nuk përmbush aspak qëllimin e saj të synuar teksa e gjithë popullata është përfutuese e një “subvencionit” të tillë, jo vetëm konsumatorët në nevojë. Do të dëshironim të theksonim se mbështetja e konsumatorëve në nevojë është një rol që duhet të kryhet nga institucionet shqiptare nëpërmjet ndihmave të drejtpërdrejta që të kenë lidhje me faturat e energjisë, sepse, nëse ofrohet me çmimet e energjisë, një gjë e tillë deformon tregun e energjisë dhe një alokim të drejtë të kostove për shpërndarjen dhe shitjet e energjisë. Të njëjtën pikëpamje me ne kanë edhe institucionet ndërkombëtare të tilla si Banka Botërore, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë – që e rekomandon fuqishëm një reforme të tillë, USAID dhe institucione të tjera të ngjashme, pikëpamje që janë shprehur nga të tilla institucione në seminare, konference dhe bisedime dypalëshe.

7.2. Tarifat individuale në lidhje me nivelet përkatëse të tensionit

Do të dëshironim gjithashtu të sillnim sërish në vëmendjen tuaj tarifat individuale për nivelet e përkatëse të tensionit. Në nuk gjejmë ndonjë arsye apo justifikim për mbajtjen e tarifave të ndryshme për të njëjtin nivel tensioni. Kjo qasje çon jo vetëm në një akolim të padrejtë të kostove ndaj grupeve përkatëse të konsumatorëve, por edhe mund të përbëjë burim për abuzime. Për pasojë, do të donim të propozonim përshtatjen e tarifave individuale ndaj të njëjtit nivel për nivelin e tensionit përkatës. Jemi të gatshëm të diskutojmë në hollësi parimet e një rialokimi të tillë dhe të arrijmë një kuptim dhe llogaritje të përbashkët.

TARIFF STRUCTURE FORECAST 2012 - 2014					
		Peak coef		1,15	1,15
		ACT	FRC	FRC	FRC
IN MWH		YTD 2011	YTD 2012	YTD 2013	YTD 2014
Industry	base	6,20	6,20	8,46	8,46
	peak	6,51	7,13	9,73	9,73
Commerce and Services	base	6,20	6,20	8,46	8,46
	peak	6,51	7,13	9,73	9,73
Agriculture	base	6,20	6,20	8,46	8,46
	peak	6,51	7,13	9,73	9,73
Others	base	6,20	6,20	8,46	8,46
	peak	6,51	7,13	9,73	9,73
Customers at 110 kV					
Industry	base	8,00	8,00	10,92	10,92
	peak	8,40	9,20	12,56	12,56
Commerce and Services	base	8,00	8,00	10,92	10,92
	peak	8,40	9,20	12,56	12,56
Agriculture	base	8,00	8,00	10,92	10,92
	peak	8,40	9,20	12,56	12,56
Others	base	8,00	8,00	10,92	10,92
	peak	8,40	9,20	12,56	12,56
Customers at 35 kV					
Industry	base	8,50	8,50	11,60	11,60
	peak	8,93	9,78	13,34	13,34
Commerce and Services	base	8,50	8,50	11,60	11,60
	peak	8,93	9,78	13,34	13,34
Agriculture	base	8,50	8,50	11,60	11,60
	peak	8,93	9,78	13,34	13,34
Others	base	8,50	8,50	11,60	11,60
	peak	8,93	9,78	13,34	13,34
Customers at 20/10/6 kV					
Industry	base	9,10	9,10	12,42	12,42
	peak	9,56	10,47	14,28	14,28
Commerce and Services	base	10,00	10,00	13,65	13,65
	peak	10,50	11,50	15,70	15,70
Wheat industry and bakeries	base	7,10	7,10	9,69	9,69
	peak	7,46	8,17	11,14	11,14
Agriculture	base	8,70	8,70	11,87	11,87
	peak	9,14	10,01	13,65	13,65
Others	base	9,70	9,70	13,24	13,24
	peak	10,19	11,16	15,22	15,22
Budgetary	base	11,50	11,50	15,70	15,70
	peak	12,08	13,23	18,05	18,05
Customers at 0,4 kV					
Commercial					
Industry	base	10,50	10,50	14,33	14,33
	peak	11,03	12,08	16,48	16,48
Commerce and Services	base	12,20	12,20	16,65	16,65
	peak	12,81	14,03	19,15	19,15
Wheat industry and bakeries	base	7,60	7,60	10,37	10,37
	peak	7,98	8,74	11,93	11,93
Agriculture	base	10,50	10,50	14,33	14,33
	peak	11,03	12,08	16,48	16,48
Others	base	12,00	12,00	16,38	16,38
	peak	12,60	13,80	18,83	18,83
Budgetary	base	14,00	14,00	19,11	19,11
	peak	14,70	16,10	21,97	21,97
Residential					
<300 kWh	base	7,70	7,70	13,22	13,22
	>300 kWh	13,50	13,50	13,22	13,22
Common spaces Private &Housolde		base	8,00	8,00	10,92
Own consumption					
Own consumption MV& LV	base	12,20	12,20	16,65	16,65
	peak	12,81	14,03	19,15	19,15
Own consumption HV		base	10,00	10,00	13,65

Fig 13: Propozimi i struktures se tarifave 2012 - 2014

8. Parimi i reflektimit të kostove reale në tarifa

Do të donim të theksonim faktin se deri më tani parimi i reflektimit të kostos nuk është aplikuar në mënyrën e duhur për llogaritjen e tarifave. Sipas Direktivës së BE 2009/72/EC, e cila është reflektuar në Traktatin e KE-së, i nënshkruar nga vendet e Europës Juglindore (parimet e direktivës janë adoptuar si *“acquis communautaire për energjinë”*, i detyruar të zbatohet nga çdo vend anëtar për sa i përket kuadrit ligjor dhe rregullator), në të cilin përcaktohet qartësisht se *“...Masa të mëtijshme duhet të ndërmerren për të garantuar tarifa transparente dhe jo-diskriminuese për akses në rrjete. Këto tarifa duhet të aplikohen ndaj të gjithë përdoruesve të sistemit në mënyrë jo-diskriminuese. Autoritetet kombëtare rregullatore duhet të miratojnë tarifa apo metodologji në bazë të propozimeve të operatorit/operatorëve të sistemit dhe përdoruesve të rrjetit. Në përmbushjen e këtyre udhëzimeve, autoritetet rregullatore duhet të sigurojnë që tarifat e rrjetit nuk janë diskriminuese dhe duhet të reflektohen në kosto, si edhe duhet të marrin në konsideratë kostot afatgjata, marxhinale, kostot e shmangura të rrjetit nga prodhimi i injektuar në shpërndarje dhe nga masat e marra për menaxhimin e kërkesës...”* Me fjalë të tjera, tarifat duhet të japin sinjalin e duhur ndaj përdoruesve të rrjetit dhe duhet të lejojnë operatorët e sistemeve të azhurnojnë dhe shtrijnë rrjetin me qëllim që të ofrojnë shërbimet e duhura në kohë, si edhe me cilësi, e cila kërkohet nga vazhdimisht nga përdoruesit.

Llogaritja e tarifës së kryer nga ERE për periudhën e tretë rregullatore (2012 – 2014) nuk ka marrë në konsideratë kostot reale në lidhje me aktivitetet e shpërndarjes dhe shitjes me pakicë.

- Kostoja e humbjeve (komponent e tarifës së shpërndarjes) duket se është në realitet shumë më e lartë sesa ajo e parashikuar nga ERE për shkak të mospranimit të Auditit të Humbjeve dhe Modelimit të Reduktimit të Humbjeve, të përgatitura nga ekspertë të pavarur. Si rezultat, CEZ Shpërndarje është e detyruar të blejë sasi më të mëdha të energjisë sesa ato të parashikuara nga ERE me qëllim që të sigurojë furnizim të pandërprerë të konsumatorëve me energji elektrike.
- Niveli i OPEX është ulur në një mënyrë arbitrare (në tarifën e shpërndarjes dhe tarifën e shitjes me pakicë), gjë që nënkupton se aktivitetet OPEX dhe CAPEX nuk përmbushen plotësisht. Me fjalë të tjera, me anë të këtij vendimi, ERE sinjalizon se kompania nuk do të jetë në gjendje të shtrijë

biznesin e saj dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimit, ndërsa shumë projekte lidhen me nivelin e kërkuar OPEX-it më të lartë - me rreth 3 miliardë lekë – sesa vendimi i ERE-s.

- Kostot në lidhje me disbalancat – sipas rregullave të tregut që janë miratuar kohët e fundit, CEZ Shpërndarje është përgjegjës për balancimin e sistemit të shpërndarjes. Vendimet për tarifën e viteve 2012 – 2014 nuk morën në konsideratë koston e disbalancave, teksa rregullorja e re e ERE-s për disbalancat hyri në fuqi në shkurt 2012. Për pasojë, kostot e CEZ Shpërndarje në lidhje me shërbimet e disbalancave duhet të llogariten në tarifën përkatëse dhe të aplikohen ndaj të gjithë përdoruesve të sistemit.

Të gjithë komponentët e paraqitur në këtë aplikim për tarifën përfaqësojnë parametra rregullatorë, të cilët janë thelbësorë dhe duhet të merren seriozisht në konsideratë me qëllim që të garantohet financimi për zbatimin e planit të investimeve, i cili pa dyshim do të ndikojë pozitivisht në treguesit teknikë dhe financiarë të CEZ Shpërndarje. Do të dëshironim të theksonim se varianti i llogaritur nuk pasqyron akoma plotësisht kostot, pikërisht në fushën e nivelit të humbjeve në rrjet, kryesisht për shkak të mospranimit të Auditit të Humbjeve dhe për shkak të faktit se supozimet e marra në konsideratë nga eksperti i pavarur në Modelimin e Reduktimit të Humbjeve bëhet i pavlefshëm për të ardhmen për shkak të mosdisponueshmërisë së financimit të programit të investimit, siç u shpjegua në pjesët përkatëse të këtij Përditësimi të Aplikimit të Tarifave. Bazuar në gjithë sa u tha më lart, ne i kërkojmë ERE-s të rishikojë qëndrimin e saj në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura në këtë dokument.